



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.44

2004

30 Qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.133, datë 1.6.2004	Për miratimin e raportit përfundimtar, konkluzioneve dhe rekomandimeve të Komisionit Hetimor Parlamentar për Telekomunikacionet, i ngritur me vendimin e Kuvendit nr.121, datë 19.2.2004	3193
	Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë, datë 10.6.2004.....	3193
Vendim i KM nr.382, datë 19.6.2004	Për miratimin e strategjisë afatgjatë të zhvillimit të sistemit shëndetësor shqiptar	3195
Vendim i KM nr.383, datë 19.6.2004	Për miratimin e procedurave, tarifave dhe masën e mbulimit të shërbimeve ekzaminuese unike, terciare të përfshira në sigurimin shëndetësor	3195
Vendim i KM nr.384, datë 19.6.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.197, datë 18.3.1996 “Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore”	3197
Vendim i KM nr.385, datë 19.6.2004	Për një ndryshim e shtesë në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve në Shërbimin Informativ Kombëtar”.	3197

Vendim i KM nr.386, datë 19.6.2004	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjedisit të degëve të mobilizimit në qytetet Përmet dhe Tepelenë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	3198
Vendim i KM nr.391, datë 19.6.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.68, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve dhe kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar	3198
Vendim i KM nr.392, datë 19.6.2004	Për një shtesë në vendimin nr.650, datë 12.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për likuidimin e pagave dhe të detyrimeve të prapambetura të ish-ndërmarrjes së prodhimit të çimentos në Fushë-Krujë”.....	3199
Udhëzim i MRRTT-MF nr.3912, datë 21.6.2004	Mbi procedurat për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit	3199
Vendim i KKRT nr.248, datë 21.6.2004	Për heqjen e licencës së "TV BUSHAT".....	3203
Vendim i KKRT nr.249, datë 21.6.2004	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TV COLOR”.....	3204

VENDIM
Nr.133, datë 1.6.2004

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR, KONKLUZIONEVE DHE
REKOMANDIMEVE TË KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR PËR
TELEKOMUNIKACIONET, I NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.121,
DATË 19.2.2004**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 20,21 dhe 22 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet Raporti Përfundimtar, konkuzionet dhe rekomandimet e Komisionit Hetimor Parlamentar për Telekomunikacionet, i ngritur me vendimin e Kuvendit nr.121. datë 19.2.2004, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Raportit Përfundimtar i bashkëlidhet mendimi i pakicës, sipas nenit 21 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit".

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

REZOLUTË

Duke mbajtur parasysh objektivin strategjik për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European;

Duke vlerësuar periudhën e stabilizim-asocimit, si një etapë shumë të rëndësishme, të domosdoshme për arritjen e këtij objekti;

Duke ndjekur në vazhdimësi marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit European dhe zhvillimin e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe duke përshëndetur angazhimin e BE-së dhe të strukturave të tij në Bruksel e në Tiranë për ndihmesën e çmuar në këtë proces;

Duke konsideruar analitik dhe realist Raportin e Komisionit European për vitin 2003 për Shqipërinë dhe duke i mirëpritur si nxitëse vlerësimet dhe qëndrimet kritike të BE-së, në lidhje me garantimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe nevojën për të përshpejtuar zbatimin e rekomandimeve të tij;

Duke vlerësuar shqetësimin se zgjedhjet e lira dhe të drejta përbëjnë një kriter themelor në plotësimin e detyrimeve për ecurinë e procesit të integritit european dhe euroatlantik;

Duke shprehur shqetësimin se korrupsioni dhe krimi i organizuar përbëjnë fenomene penguese për zhvillimin dhe kërcënuese për stabilitetin e vendit;

Duke konstatuar mangësitë në funksionimin e administratës publike;

Duke vlerësuar punën e Kuvendit për plotësimin dhe standardizimin e kuadrit ligjor;

Duke theksuar problematikën e dukshme dhe nevojën për thellimin e luftës kundër ekonomisë informale dhe fenomeneve monopolizuese;

Duke vlerësuar të domosdoshëm thellimin e reformave në sistemin e drejtësisë, si dhe në Policinë e Shtetit, në mënyrë që të arrihet eliminimi i korrupsionit në to dhe përmirësimin e transparencës për funksionimin e shtetit ligjor dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

Duke vlerësuar se bashkëpunimi politik dhe institucional i të gjitha forcave politike, si dhe me shoqërinë civile është i domosdoshëm për reforma më të thella, me qëllim që vendi të realizojë me sukses një progres të dukshëm e të qëndrueshëm;

Bazuar në rezolutat e Kuvendit të muajve mars 2003 dhe prill 2004, lidhur me procesin e integritetit dhe të negociatave për MSA dhe në rekomandimet e bëra nga Komisioni i BE-së në Raportin e tij Vjetor për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (mars 2004), ku merr një rol të rëndësishëm përshpejtimi i procesit të integritetit në familjen europiane;

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I kërkon Qeverisë që në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë, institucionet e tjera dhe shoqërinë civile të adoptojë Planin Kombëtar të Veprimit për zbatimin e prioriteteve të Partneritetit European, ku të detajohen, brenda muajit qershor 2004, të gjitha hapat që do të ndërmerren në përmbushje të të gjitha detyrimeve për plotësimin e standardeve të kërkuara nga procesi i stabilizim-asocimit në fushën e reformave dhe përafrimit të legjislacionit, duke e paraqitur për miratim në Kuvendin e Shqipërisë;

I kërkon Qeverisë dhe institucioneve të tjera përqendrim në zbatimin e reformave të nevojshme për progres në kuadër të MSA, si dhe garantimin e funksionimit të duhur të institucioneve demokratike, përmirësimin e funksionimit dhe stabilitetin e administratës shtetërore;

Angazhohet dhe i kërkon Qeverisë dhe institucioneve të drejtësisë koordinim dhe veprim më konkret në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nëpërmjet ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve institucionale, për të hetuar dhe penalizuar këto fenomene; konkretizimin dhe intensifikimin e punës në sistemin gjyqësor, në dogana dhe në polici për të përmbushur kështu objektivat prioritarë në këtë drejtim;

Angazhohet dhe i kërkon Qeverisë brenda muajit shtator përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit të përshtatshëm, ku të normohen qartë çështjet që kanë të bëjnë me:

- Konfliktin e intereseve;
- Mospengimin e hetimeve për shkak të imunitetit;
- Garantimin e shmangies së abuzimeve për emërimet në administratën shtetërore;

I kërkon Qeverisë të paraqesë në Kuvend programin e veprimeve për shpejtimin e reformave që synojnë:

- përfundimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha dhe atyre strategjike, si dhe të sektorit financiar;
- përmirësimin e legjislacionit tregtar për të garantuar rregullat e konkurrencës së lirë dhe luftës kundër fenomeneve monopolizuese të tregut;
- thjeshtëzimin e procedurave të licencimit dhe të nxjerrjes së detyrimeve fiskale, duke i përafruar me standardet e BE-së dhe duke eliminuar hapësirat e veprimit subjektiv dhe arbitrar të administratës publike;
- zvogëlimin e ekonomisë informale dhe evazionit fiskal për një rritje të qenësishme të rendimentit fiskal;

Nxit Qeverinë që brenda 2 muajve të paraqesë për miratim në Kuvend ligjin për transparencën në financimin e partive politike;

I kërkon Qeverisë të nxisë iniciativat e bashkëpunimit rajonal, nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve ndërkufitare dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të këtij lloji;

I kërkon Qeverisë përshpejtimin e veprimeve për të plotësuar të gjitha detyrimet që vendos BE-ja, në mënyrë që të mundësohet lëvizja e lirë e shtetasve shqiptarë;

Duke u mbështetur në rëndësinë e procesit të integritetit dhe në përvojën parlamentare europiane, atë rajonale, si dhe në sugjerimin e Raportit të Komisionit European, Komisioni *Ad-Hoc* i Integritetit të shndërrohet në komision të përhershëm;

I kërkon sistemit të drejtësisë të zbatojë me korrektësi ligjin kundër krimit dhe trafikeve të paligjshme, si dhe të garantojë dhënien e drejtësisë, sipas ligjit, për të gjithë shtetasit dhe angazhohet për të dhënë të gjithë mbështetjen e nevojshme për reformimin dhe pavarësinë e këtij sistemi;

U kërkon institucioneve të tjera kushtetuese, Avokatit të Popullit dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, të kryejnë detyrat e tyre në forcimin e institucioneve, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi;

U bën thirrje partive politike, Qeverisë dhe institucioneve të tjera të bashkëpunojnë për respektimin e kërkesave të ODHIR-it dhe elementeve të tjera të nevojshme, ligjore dhe kushtetuese, për të garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, konform standardeve europiane;

Fton të gjithë faktorët politikë, ekonomikë dhe shoqërinë civile që të vazhdojnë të japin kontributin dhe mbështetjen e tyre për mbarëvajtjen e procesit të stabilizim-asocimit të vendit në BE;

Nxit përsheptimin e reformës në administratën publike, duke përmirësuar më tej ligjin "Për shërbimin civil", duke forcuar institucionet përgjegjëse, duke zgjeruar fushën e zbatimit të këtij ligji dhe duke garantuar zbatimin e kriterëve të tij për emërimet në administratë;

Rikonfirmon vullnetin për mbështetje legjislative dhe kontroll parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të BE-së, veçanërisht në fushën e reformave të përafrimit të legjislacionit dhe atyre ekonomike.

Tiranë, më 10 qershor 2004

VENDIM
Nr.382, datë 19.6.2004

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË AFATGJATË TË ZHVILLIMIT TË SISTEMIT SHËNDETËSOR SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e strategjisë afatgjatë të zhvillimit të sistemit shëndetësor shqiptar.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.383, datë 19.6.2004

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE, TARIFAVE DHE MASËN E MBULIMIT TË SHËRBIMEVE EKZAMINUESE UNIKALE, TERCIARE TË PËRFSHIRA NË SIGURIMIN SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2 shkronja "c", e 14 paragrafi i fundit, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së ekzaminimeve unikale, terciare dhe të tarifave, që do të mbulohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e masës së mbulimit të shpenzimeve të personit të siguruar për shërbimin e këtyre ekzaminimeve nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor si më poshtë vijon:

a) 100 për qind për fëmijët 0-12 vjeç, invalidët e plotë, invalidët e luftës, veteranët, të sëmurët me TBC dhe CA.

b) 90 për qind për kategoritë e tjera të të siguruarve, në përputhje me ligjin nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Për kategorinë e të siguruarve sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, të zbatohet bashkëpagesa në masën 10 për qind të tarifave të mësipërme.

4. Për të kryer ekzaminimet unikale, terciare, të siguruarit duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

Librezën e shëndetit, dokumentin e identifikimit dhe rekomandimin e konsultës së shërbimit përkatës.

5. Pacientët e pasiguruar mund t’i bëjnë ekzaminimet e mësipërme, duke paguar të plotë tarifën e përcaktuar në listën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

6. Në raste urgjente, shpenzimet për ekzaminimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë.

7. Dega e Shërbimeve Spitalore të Sigurimeve Shëndetësore është përgjegjëse për realizimin dhe kontrollin e ekzaminimeve unikale, terciare dhe për mbulimin e shpenzimeve, sipas dokumentacionit të shpenzimeve faktike mujore, të paraqitura nga institucioni shëndetësor, terciar.

8. Të ardhurat nga shumat e xhiruara nga ISKSH-ja, të kalojnë në buxhetin e institucionit shëndetësor terciar, si të ardhura me destinacion dhe përdorimi i tyre të bëhet në përputhje me vendimin nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

9. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe drejtori i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

LISTA E EKZAMINIMEVE UNIKALE, TERCIARE TË MBULUARA NGA SIGURIMET SHËNDETËSORE

EKZAMINIMI	ÇMIMI
1. Rezonanca magnetike pa kontrast	20 000 lekë
2. Rezonanca magnetike me kontrast	35 000 lekë
3. CT-Scann	12 500 lekë
4. CT-Scann koke, kolone me kontrast	12 500 lekë
5. CT-Scann trupi me kontrast	12 500 lekë
6. Mamografi	3 000 lekë
7. Litrotripsia	18 000 lekë
8. Angiografi	40 000 lekë
9. Koronagrofi	40 000 lekë
10. Fibrogastrocopi	3 800 lekë
11. Fibrocolonoscopi	3 800 lekë

VENDIM
Nr.386, datë 19.6.2004

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISIT TË DEGËVE
TË MOBILIZIMIT NË QYTETET PËRMET DHE TEPELENË, TË CILAT JANË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR DISA
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT Ë MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjedisëve të degëve të mobilizimit në qytetet Përmet dhe Tepelenë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit dhe të kalojë te prefekti i qarkut të Gjirokastrës, për t’u përdorur për sistemimin e stacioneve të PMNZSh-së në këto qytete.

2. Pronat me numrat rendorë 652 “Dega e mobilizimit”, Përmet dhe 662 “Dega e mobilizimit”, Tepelenë, me të gjitha elementet përbërëse, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Prefektit të qarkut të Gjirokastrës, i ndalohet t’ua ndryshojë destinacionin pronave të përcaktuara në këtë vendim, t’i tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Ekonomisë, prefekti i qarkut Gjirokastrë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.391, datë 19.6.2004

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.68, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE DHE KUSHTEVE TEKNIKE TË
PROJEKTIMIT DHE TË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin” dhe të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.68, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në lidhjen nr.1 të pikës 1, shtohet pika 41 me këtë përmbajtje:

“41. S SH ENV 229010-1:2004 Prodhime të parapërgatitura prej betoni, traveta të paranderura, traveta me beton të armuar-traliçe.”.

2. Në lidhjen nr.2 të pikës 2 shtohen “Rregullat teknike të projektimit dhe të zbatimit për tubat plastikë, për sistemet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.392, datë 19.6.2004

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.650, DATË 12.12.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LIKUIDIMIN E PAGAVE DHE TË DETYRIMEVE TË
PRAPAMBETURA TË ISH-NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇIMENTOS
NË FUSHË-KRUJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 124 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.650, datë 12.12.2002 të Këshillit të Ministrave, në pasqyrën e përcaktuar në pikën 1 që i bashkëlidhet vendimit të shtohet:

“Listëpagesa e 16 ish-punonjësve të sektorit të transportit,
për vitin 1999, në masën 40 %

631 858 lekë.”.

2. Fondi për likuidimin e detyrimeve të mësipërme të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “shpenzime për paga”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

3. Pagesa e këtyre punonjësve të kryhet në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

4. Ngarkohet Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr.3912, datë 21.6.2004

MBI PROCEDURAT PËR PËRBALLIMIN NGA SHTETI TË SHPENZIMEVE TË
SHËRBIMIT TË VARRIMIT PËR SHTETASIT SHQIPTARË, QË VDESIN BRENDA
DHE JASHTË SHTETIT

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.426, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit ” ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 26.11.2003 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.426, datë 9.7.1998 “Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin

brenda dhe jashtë shtetit””, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Neni 1

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit, përcaktimin e rasteve të veçanta, si dhe përcaktimin e masës së kontributit në rastet kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjarët e të ndjerit.

Neni 2

Buxheti i Shtetit për çdo rast fatkeqësie jep, për shtetasit shqiptarë, një ndihmë të caktuar në lekë. Masa e kësaj ndihme përcaktohet sipas vendbanimit në zona rurale apo urbane, si dhe specifikohet për grup-moshat 0-14 vjeç dhe mbi 14 vjeç, sipas listës bashkëngjitur vendimit të Këshillit të Ministrave nr.426, datë 9.7.1998.

Neni 3

Ndihma në lekë tërhiqet nga të interesuarit pranë zyrës së financës në bashkinë apo komunën përkatëse kundrejt paraqitjes së certifikatës së vdekjes së të ndjerit me shënimin “Shpenzime varrimi”.

Për çdo rast pagese, financa e bashkisë apo e komunës, sipas certifikatës së paraqitur, llogarit masën e ndihmës, si dhe plotëson mandatpagesën.

Neni 4

Shpenzimet për ndihmë planifikohen në buxhetin e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe përdoren mbi bazën e kërkesave të organeve të pushtetit vendor.

Neni 5

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, me fonde të Buxhetit të Shtetit, organizon shërbimin e transportit të kufomave dhe të eshtrave vetëm për rastet e fatkeqësive të ndodhura jashtë territorit të vendit, për persona që janë dërguar me shërbim ose mjekim shëndetësor nga shteti, punonjësit e përfaqësive diplomatike, si dhe për raste të veçanta, sipas kërkesës së bërë nga institucione, njësi të qeverisjes vendore apo shoqata të ndryshme.

Transporti i kufomave dhe eshtrave për kategoritë e cituara më sipër bëhet me automjetet e funeralit që ka në inventarin e saj Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit. Të gjitha shpenzimet e transportit ku përfshihen karburante, dietat për drejtuesit e automjetit, taksat e ndryshme kufitare dhe ato të lëvizjes, telefonatat e dokumentuara, biletat e tragetit, fjetja etj. përballohen nga buxheti i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

Neni 6

Shpenzimet e tjera, si: shpenzime spitali, morgu, zhvarrosje, arkivoli, si dhe detyrime të tjera për përgatitjen e kufomës për transportimin në atdhe, përballohen nga familja apo të afërmit e të ndjerit.

Neni 7

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit do të nisë automjetet për transportimin e kufomës apo eshtrave vetëm pas kërkesës zyrtare nga zyra konsullore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila duhet të sqarojë në kërkesën e bërë gjeneralitetet dhe vendndodhjen e saktë të të

ndjerit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse nga familjarët, përfundimin e procedurave që lejojnë transportin në Shqipëri.

Neni 8

Për shtetasit shqiptarë, që vdesin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjarët e të ndjerit, Buxheti i Shtetit rimbursen një pjesë të këtyre shpenzimeve, llogaritur me tarifën 70 lekë/km nga qendra administrative ku ka ndodhur vdekja deri në qendrën administrative ku do të bëhet varrimi.

Neni 9

Për transporte të kryera nga vende jashtë Europës, shlyerja do të bëhet në masën 1500 dollarë. Kjo pagesë do të bëhet me lekë duke konvertuar valutën e huaj me kursin zyrtar ditën që plotësohet çeku për pagesë.

Neni 10

Pagesa e familjarëve do të bëhet nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit kundrejt këtyre dokumenteve :

- a) Dokumenti i vdekjes nga shteti ku ka ndodhur vdekja .
 - b) Faturë, biletë apo dokument tjetër, që vërteton se shpenzimet e transportit i kanë kryer familjarët apo të afërmit e të ndjerit.
 - c) Vërtetimin e varrimit në Shqipëri .
 - d) Certifikatë vdekje nga zyra përkatëse e gjendjes civile në Shqipëri.
 - e) Letërnjoftimin ose fotokopje e noterizuar e familjarit që do ta tërheqë shpërblimin.
- Dokumentacioni i mësipërm duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar. Dokumentacioni në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer në shqip dhe i noterizuar.

Neni 11

Masa e pagesës të tërhiqet pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit brenda një viti nga dita e sjelljes së kufomës në Shqipëri.

Në rastet kur shpenzimet e transportit për sjelljen e kufomës apo eshtrave në Shqipëri kryhen falas nga shteti përkatës apo shoqata të ndryshme, familjarët e të ndjerit nuk përfitojnë pagesë të transportit nga shteti shqiptar.

Neni 12

Këshillat e qarqeve, bashkitë ose komunat, nga buxheti i tyre, përballojnë heqjen, transportimin dhe rivarrimin e eshtrave të të ekzekutuarve, me ose pa vendim gjyqi, të burgosurve politikë, që kanë vdekur në burg ose në vendet e dënimit, pa u dënuar.

Për kryerjen e punimeve përkatëse, këshillat e qarqeve, bashkitë ose komunat ngarkojnë njësi të shërbimit që kanë në vartësi, të cilat përpilojnë dokumentacionin përkatës (faturë, situacion etj.) për shpenzimet e kryera në fakt. Në bazë të këtij dokumentacioni bëhet dhe financimi i tyre.

Neni 13

1. Rastet e veçanta, për të cilat me fonde të Buxhetit të Shtetit organizohet shërbimi i transportit të kufomave dhe eshtrave, konsiderohen këto kategori personash:

- Personalitete të shquara të artit, mbajtës i titullit “Artist i Popullit”.
- Personalitete të shquara të shkencës, mbajtës i titullit “Profesor”.
- Personalitete të shquara të sportit, mbajtës i titullit “Mjeshtër sporti”.

- Invalid dhe veteranë të Luftës Nacionalçlirimtare.
- Persona me aftësi të kufizuar.

Propozimet për organizimin e shërbimit të transportit të kufomave dhe të eshtrave për personat e lartshënuar bëhen nga institucione qendrore, njësi të qeverisjes vendore apo shoqata të ndryshme ku ata bëjnë pjesë dhe miratohen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

Neni 14

Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit me nr.4252/1, Ministrisë së Financave me nr.2125/4 shfuqizohet.

Neni 15

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I RREGULLIMIT TË
TERRITORIT DHE TË TURIZMIT
Bashkim FINO**

**MINISTRI I FINANCVE
Arben MALAJ**

LISTA E RRETHEVE TË GRUPUARA SIPAS MASËS SË NDIHMËS NË RAST FATKEQËSIE

Nr.	Rrethi	Zonat urbane		Zonat rurale	
		0-14 vjeç	Mbi 14 vjeç	0-14 vjeç	Mbi 14 vjeç
I	TIRANA	5800	9600	2200	3600
II	SHKODËR	5000	8400	2200	3600
	DURRËS	5000	8400	2200	3600
	ELBASAN	5000	8400	2200	3600
	VLORE	5000	8400	2200	3600
	KORÇË	5000	8400	2200	3600
	FIER	5000	8400	2200	3600
	BERAT	5000	8400	2200	3600
	GJIROKASTËR	5000	8400	2200	3600
	KAVAJË	5000	8400	2200	3600
	KRUJË	5000	8400	2200	3600
	LEZHË	5000	8400	2200	3600
	LUSHNJË	5000	8400	2200	3600
	POGRADEC	5000	8400	2200	3600
	SARANDË	5000	8400	2200	3600
III	DIBËR	4300	7200	2200	3600
	GRAMSH	4300	7200	2200	3600
	KOLONJË	4300	7200	2200	3600
	KUKËS	4300	7200	2200	3600
	KURBIN	4300	7200	2200	3600
	LIBRAZHD	4300	7200	2200	3600
	MIRDITË	4300	7200	2200	3600
	MAT	4300	7200	2200	3600
	PËRMET	4300	7200	2200	3600
	PUKË	4300	7200	2200	3600
	SKRAPAR	4300	7200	2200	3600
	TEPELENË	4300	7200	2200	3600
	TROPOJË	4300	7200	2200	3600
	BULQIZË	4300	7200	2200	3600

VENDIM
Nr.248, datë 21.6.2004

PËR HEQJEN E LICENCËS SË "TV BUSHAT"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, i përbërë nga:

Sefedin Çela	Kryetar
Albert Minga	Zëvendëskryetar
Apostol Noti	Anëtar
Pashk Përvathi	Anëtar
Lazër Stani	Anëtar
Ilir Kulla	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit TV BUSHAT

Baza ligjore: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5, neni 34 pika 5 dhe neni 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, dhe vendimi nr.243, datë 21.5.2004 i KKRT-së.

Me vendimin nr.243, datë 21.5.2004 “Mbi vlefshmërinë e licencës së TV BUSHAT” është vendosur paraprakisht t’i hiqet licenca këtij subjekti, duke i lënë një afat prej 15 ditësh, për të dhënë mendimin e tij në lidhje me këtë vendim. Me shkresën e KKRT-së, me nr.577 prot., datë 24.5.2004, TV BUSHAT është njoftuar mbi vendimin nr.243, datë 21.5.2004 dhe nuk ka kthyer asnjë përgjigje.

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE I TELEVISIONIT,

pasi dëgjoi relatorët e çështjes, Argita Shkupi, Ermira Musha dhe Pirro Koçi, ndërsa subjekti në mungesë,

VËREN:

TV BUSHAT me pronar z.Simon Gjondrekaj është licencuar si operator televiziv vendor privat me vendimin nr.157, datë 30.7.2003 të KKRT-së, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5-vjetësh. Zona e licencimit të tij është komuna e Bushatit.

Në datën 21.4.2004 një grup inspektimi i KKRT-së ka shkuar në vendndodhjen studios së transmetimit të TV BUSHAT dhe ka mbajtur një procesverbal të shoqëruar me aktin e inspektimit.

Në bazë të procesverbalit dhe aktit të inspektimit rezulton se TV BUSHAT nuk ishte në transmetim. Studioja ku duhej të ishin instaluar aparaturat e transmetimit të këtij televizioni ishin krejtësisht të mbyllura.

KKRT-ja konstaton se TV BUSHAT nuk ka tërhequr licencën dhe nuk ka realizuar asnjë detyrim financiar që nga data e licencimit të tij. Këto detyrime janë si më poshtë:

- Taksa vjetore për shërbimet radiotelevizive në shumën prej 24 mijë lekësh;
- Pagesa vjetore e licencës dhe pagesa për marrjen e licencës në shumën prej 34.3 mijë lekësh.

Gjithashtu, ky subjekt nuk i është përgjigjur asnjëherë korrespondencës së KKRT-së.

Në bazë të nenit 34 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, KKRT-ja ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit, kur pas fillimit të transmetimit, gjatë një viti kalendarik, nuk transmetohet 30 ditë, pa llogaritur ndërprerjet për arsye teknike që nuk varen nga mbajtësi i licencës.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 dhe nenit 34 pika 5 dhe nenit 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion e televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr.243, datë 21.5.2004 të KKRT-së,

VENDOSI:

1. T’i heqë licencën subjektit TV BUSHAT.
2. Licenca nr.062/TVL bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti ka të drejtën e ankimit në gjykatë.
4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
5. Kur është e domosdoshme, mbështetur në nenin 137/5 “Bashkëpunimi me organet e tjera” të bashkërendohen veprimet me organet tatimore e policore.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

VENDIM

Nr.249, datë 21.6.2004

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“TV COLOR”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “TV COLOR” sh.a.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin prill, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqëria “TV COLOR” sh.a. me vendndodhje në qytetin e Ballshit, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5-vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
 2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

SË SHPEJTI NË BOTIM:
INDEKSI TEMATIK DHE KRONOLOGJIK
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

Doli nga shtypi më 30.6.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë